



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2019-2021

1. Misioni

Misioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) është zhvillimi dhe mbarëvajtja e një sistemi të pavarur gjyqësor i cili do të ofron shërbime të paanshme të gjithë qytetarëve dhe i cili do të jetë funksional në të gjitha aspektet e organizimit dhe funksionimit të tij.

Sistemi Gjyqësor i Kosovës do të jetë i pavarur, me qasje për të gjithë, i drejtë, efikas dhe i përgjegjshëm në punën e tij dhe i cili do të funksionoi sipas standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës.

2. Situata aktuale

Sistemi Gjyqësor i Kosovës, përballet me sfida që dalin nga nevoja e rritjes së performancës së gjyqësorit dhe zbatimit të legjislacionit të ri në fuqi. Zbatimi i Ligjit mbi Gjykatat, (Ligji Nr.03/L-199 i cili është në fuqi nga 1 janari 2011), Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Ligji nr. 03/L-223), i cili është në fuqi prej datës 3 maj 2011) si dhe Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (Ligji Nr. 04/ L-033 në fuqi që nga janari i vitit 2012).

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka përfunduar dhe është në proces të realizimit të:

- Planit Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës, për periudhën 2014-2019.
- Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra
- Strategjinë e Komunikimit, për periudhën 2014-2019.

Janë hartuar aktet kryesore nënligjore nga grupi punues i formuar nga KGJK për zbatimin e plotë të Ligjeve që përkojnë me Gjyqësorin:

- Janë hartu dhe aprovu gjithsej 10 Rregullore dhe 3 Udhëzime Administrative të cilat kanë qenë obligim i KGJK-së për zbatim të pakos së Gjyqësorit.
- Miratimi i Matricës lidhur me rishikimin e Strategjisë kundër korrupsionit 2013-2017,

- Miratimi i Udhëzuesit 01/2017 për zbatimin e nenit 12, 13 dhe 19 të Ligjit nr.05/L-129 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr.04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale.
- Janë emëruar 52 gjyqtare për të gjitha Gjykatat Themelore.
- Janë emëruar (konform Marrëveshjes për Drejtësi) 41 gjyqtar dhe 115 staf administrativ **si një ndër objektivat e kaluara dhe e arritur shumë e rëndësishme për integrimin e plotë të Sistemit Gjyqësor të Kosovës.**
- Në vitin 2017 janë emëru gjithsej 95 gjyqtar si dhe janë avansu gjithsej 5 gjyqta, një nga Gjykata e Apelit në Gjykatën Supreme dhe 4 prej tyre janë avancuar nga Gjykatat Themelore në Gjykatën e Apelit.
- Janë emëru të gjithë kryetarët e gjykatave themelore përveç kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, dhe gjyqtarët mbikëqyrës në Degën e Novobërdës, Kamenicës, Leposaviqit dhe Zubin Potokut.
- Është bërë vlerësimi i performancës së gjyqtarëve konform nenit 19 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, janë monitoruar gjashtë dhjetë e gjashtë (66) gjyqtar, ku dy (2) gjyqtarë, kanë qenë me mandat fillestar, pesëdhjetë e katër (54) me mandat të përhershëm, të përzgjedhur sipas metodës RANDOM, dhe dhjetë (10) gjyqtarë që kanë qenë kandidatë për ngritje në detyrë.
- Është në implementim Strategjia për Teknologji Informative dhe Komunikim (TIK) 2012-2017.
- Është vazhduar me investime në infrastrukturën gjyqësore ku është në përfundim e sipër ndërtimi objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, pastaj në Novo Bërdë dhe Graqanicë.

3. Objektivat

Këshilli Gjyqësor i Kosovës planifikon të realizoj misionin e tij përmes arritjes së objektivave të dhëna më poshtë:

Objektivi 1 Garantimi i pavarësisë së Sistemit Gjyqësor.

Aktiviteti 1.1 Ndërtimi i një sistemi stabil të bërjes së politikave në interes të gjyqësorit, si dhe monitorimi efikas i zbatimit të vendimeve të KGJK-së.

1.2 Respektimi i standardeve ndërkombtare dhe përfaqsimi gjithëpërfshirës i gjyqtarëve nga të gjitha nivelet e gjyqësorit në Kosovës.

1.3 Ndërtimi i sistemit për zhvillimin e karrieres së gjyqtarëve dhe personelit administrativ në gjykata në bazë të rezultateve të performancës pas vlersimit.

Objektivi 2 Zhvillimi i aktiviteteve në zbatim të dispozitave kushtetuese për një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm si dhe emërimi i gjyqtarëve në bazë të kriterëve objektivë dhe realizimi i përgjegjësisë në funksion të avansimit të efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës si dhe

zbatimi i Strategjisë shtetërore për lëndët e vjetra dhe zgjidhja me kohë e të gjitha lëndëve të evidentuara nëpër gjykata.

- Aktiviteti 2.1 Emërimi i gjyqtareve në pozitat vakante
- 2.2 Nxjerrja e akteve nënligjore
- 2.3 Procedimi me kohë i lëndëve gjyqësore
- 2.4 Publikimi i vendimeve gjyqësore
- 2.5 Publikimi i raporteve
- 2.6 Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve
- 2.7 Përmirësimi i procedurës dicitpline ndaj gjyqtarëve
- 2.8 Funksionimi i sistemit qendror për evidencë penale

Objektiva 3. Krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së gjykatave me qëllim të plotësimit të nevojave që dalin nga reforma gjyqësore.

- Aktiviteti 3.1 Ndërtimi i objekteve të reja për Gjykatat.
 - Ndërtimi i objektit të gjykatës themelore në Prizren.
 - Ndërtimi i objektit të gjykatës themelore në Mitrovicë.
 - Ndërtimi i objektit të gjykatës themelore në Pr. dega në Fushë Kosovë.
 - Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese të gjykatave.
- Aktiviteti 3.2 Themelimi i degëve të reja të gjykatave si në Fushe Kosovë, Shtime dhe Junik.
- Aktiviteti 3.3 Funksionalizimi i sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve (SIML) në zbatim të strategjisë për TIK.
- Aktiviteti 3.4 Sigurimi i pajisjeve për audio dhe video incizim të seancave në procedurë penale siç parashihet në kodin e procedurës penale.

Tabela 1 : Trendet e financimit 2017-2018 dhe vlerësimet 2019-2021

Organizata buxhetore	Viti 2017 Shpenzimi	Viti 2018 Buxhetuar	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar
Total	19,602,403	23,495,024	27,992,385	29,980,125	29,988,053
Numri i punëtorëve	2,159	2,271	2,416	2,496	2,576
Paga dhe mëditje	14,622,640	17,731,599	19,768,539	20,997,731	21,675,659
Mallra dhe shërbime	3,545,741	4,068,425	5,281,846	5,800,394	5,960,394
Shpenzime komunale	396,629	450,000	502,000	532,000	562,000
Subvencione dhe transfere	385,470	350,000	350,000	350,000	350,000
Shpenzime kapitale	651,922	895,000	2,090,000	2,300,000	1,440,000
Burimet e financimit	19,602,403	23,495,024	27,992,385	29,980,125	29,988,053
Garantet qeveritare	19,411,317	21,941,166	26,438,527	28,426,267	28,434,195

Financimi nga të hyrat e AKP-së	-				
Të hyrat vetanake	182,085	1,553,858	1,553,858	1,553,858	1,553,858
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06					
Grantet nga Donatorët *	9,000				

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2019-2021)

Politika e re prioritare 1.	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar
Përshkrimi :			
Ndërlidhja e politikës së re me Dokumentet Strategjike			
Total	3,415,076	4,493,004	4,500,932
Numri i punëtorëve	145	225	305
Paga dhe mëditje	1,393,076	2,071,004	2,748,932
Mallra dhe shërbime	800,000	960,000	1,120,000
Shpenzime komunale	52,000	82,000	112,000
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale	1,170,000	1,380,000	520,000
Burimet e financimit			
Grantet qeveritare	3,415,076	4,493,004	4,500,932
Financimi nga të hyrat e AKP-së			
Të hyrat vetanake			
Financimet nga huamarrjet	-	-	-
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04			
Financimi nga Klauzola e investimeve -06			
Grantet nga Donatorët*			

***Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimeve të financimit.**

Tabela 3. Propozimet për projektet të cilat financohen nga klauzola e investimeve 2019-2021

Projektet kapitale	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar	Totali 2019-2021	Vlera totale e projektit (kur projekti është mbi periudhën 2019-2021)
Emri i projektit 1:					
Total	-	-	-	-	-
Kostoja e vlerësuar e projektit për investime*					
Burimi i financimit					
Financimi nga klauzola e investimeve	-	-	-	-	-

***Shpenzimet operative të cilat paraqiten para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit duhet të mbulohen nga kursimet e brendshme të OB.**

Tabela 4. Propozimet për projektet të cilat financohen nga të hyrat nga AKP-së 2019-2021

Projektet kapitale	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar	Totali 2019-2021	Vlera totale e projektit (kur projekti është mbi periudhën 2019-2021)
Emri i projektit 1:					
Total	-	-	-	-	-
Kostoja e vlerësuar e projektit për investime*					
Burimi i financimit					
Financimi nga të hyrat e AKP-së	-	-	-	-	-

*Shpenzimet operative të cilat paraqiten para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit duhet të mbulohen nga kursimet e brendshme të OB.

Tabela 5. Draft-Parashikimi i të Hyrave Jo-tatimore të Organizatës Buxhetore 2019-2021

Organizata Buxhetore:					
Kodi 5 shifror i të hyrës jo-tatimore:	Viti 2017 Arkëtimi	Viti 2018 Vlerësuar	Viti 2019 Vlerësuar	Viti 2020 Vlerësuar	Viti 2021 Vlerësuar
Totali	7,708,614	7,900,000	8,025,000	8,095,000	8,160,000
50101	1,414,036	1,197,000	1,100,000	950,000	900,000
50102	3,575,582	3,640,000	3,800,000	3,950,000	4,000,000
50021	2,718,996	3,063,000	3,125,000	3,195,000	3,260,000

Në tabelën 2 të përfshira edhe në tabelën 1, janë paraparë propozimet për politika të reja për tri vitet e ardhshme 2019-2021, të ndara sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe mëditje 1,393,076 € për vitin 2019; 2,071,004 € për vitin 2020 dhe 2,748,932 € për vitin 2021, për 305 pozita, prej tyre 5 bashkpuntor profesional për divizionin e apelit në Mitrovicë, 5 gjyqtar për Gjykatën e Apelit, 25 gjyqtar për Gjykatat Themelore, 15 pozita për bashkpuntor profesional dhe 15 pozita për zyrtarë ligjor në Gjykatat Themelore dhe në Gjykatën e Apelit për këta gjyqtar, ndërsa për bashkupuntor profesional në gjykata për të permbushur kriteret që qdo gjyqtar të ketë një bashkpuntor profesional janë parashiku nga 80 bashkpuntor profesional shtesë në qdo vit 2019-2021 (aktualisht është tre gjyqtar një bashkpuntor profesional)
- Mallra dhe shërbime 800,000 € për vitin 2019; 960,000 € për vitin 2020 dhe 1,120,000 € për vitin 2021 (në këtë kategori përveq tjerash janë të parapara për tri vitet e ardhshme 900,000 € për blerje të liqencave dhe paisjeve tjera për Teknologji Informative të cilat nevojiten kryesisht për Implementim të projektit SMIL si dhe 145,000 € për shpenzimet e avokatëve sipas detyrës zyrtare).
- Shpenzime të komunalive 52,000 € për vitin 2019; 82,000 € për vitin 2020 dhe 112,000 € për vitin 2021.
- Shpenzime kapitale nevojiten gjithsej 1,170,000 € për vitin 2019; 1,380,000 € për vitin 2020 dhe 520,000 € për vitin 2021 dhe atë sipas këtyre projekteve: Është paraparë të ndërtohet një objekt i ri i Gjykatës Themelore në Mitrovicë (pjesën jugore) kostoja e të cilit objekt do jetë 1,300,000 € për vitin 2019 dhe 2020 (qiraja mujore e shfrytëzimit të objektit aktual është 4,992 € të cilën ja paguajm AKP); projekt tjetër është ndërtimi i objektit të gjykatës Themelore në Prizren, edhe pse

ekzistojn projeksionet buxhetore dhe mjetet prej 780,000 €, për tri vitet e ardhshme do të nevojiten edhe 1,720,000 € për të realizuar këtë projekt në tërësi. Gjithashtu për të themeluar dhe funksionalizuar degët e gjykatave themelore në Shtime dhe Junik të parapara me pakon ligjore për gjyqesorin, nevojiten gjithsej 1,200,000 € për tri vitet e ardhshme (2019-2021).

6. Përmbledhje e Informatave Kyçe të Performancës

Tabela më poshtë është selektim i indikatorëve kyç të performancës për programet buxhetore.

Indikatorët Kyç të Performancës	2016 aktual e	2017 aktual e	2018 buxheti	2019 plani	2020 plani	2021 plani
Programi Gjykatat dhe Sekretariati						
Numri i lendeve të zgjidhura në gjykata	479937	310880	310880	310880	310880	310880
Numri i gjyqtareve të angazhuar	322	317	317	450	450	450
Numri mesatar i lëndëve për gjyqtar	1490	981	691	691	691	691
Numri i stafit administrativ në gjykata	936	936	936	936	936	936
Numri mesatar i stafit administrativ për një gjyqtar	2.9	3.7	3.7	3.2	3.2	3.2
Shërbimi administrativ / teknik	505	505	505	505	505	505
<i>Sqarim: Është dhënë numri i lendeve të zgjidhura gjatë vitit 2017 dhe numri aktual i gjyqtareve dhe stafit mbështetës. Është nxjerr mesatarja e lendeve të kryera për një gjyqtar. Është nxjerr mesatarja e stafit mbështetës për një gjyqtar.</i>						
Programi Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD)						
Numri i rasteve në ZPD	591	500	510	510	510	510
Numri i inspektoreve/prokurorëve disiplinor të angazhuar	5	4	4	4	4	4
Numri i rasteve për inspektor	118	125	127	127	127	127
Numri i stafit profesional/administrativ në ZPD	13	16	21	21	21	21
Numri mesatar i stafit administrativ për një inspektor	2.6	4.0	5.25	5.2	5.2	5.2
<i>Sqarim: Është dhënë numri i lendeve të zgjidhura gjatë vitit 2017 dhe numri aktual i inspektoreve/prokurorëve disiplinor dhe stafit profesional dhe mbështetës. Është nxjerr mesatarja e lendeve të kryera për një</i>						

Indikatorët Kyç të Performancës	2016 aktual e	2017 aktual e	2018 buxheti	2019 plani	2020 plani	2021 plani
<i>drejtor/inspektor/prokuror disiplinor. Është nxjerr mesatarja e stafit profesional mbështetës për një drejtor/inspektor/prokuror disiplinor.</i>						
Programi Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore						
Numri i zyrtareve shqyrtues te performances	4	4	5	5	5	5
Numri i performancave për një vit	2	4	5	5	5	5
Numri i subjekteve te performuara për një performancë	4	6	6	6	6	6
Totali i subjekteve te performuar brenda një viti	8	24	30	30	30	30
<i>Sqarim: Është dhënë numri i te punësuarve, duke dhënë numrin e performancave te shqyrtuara dhe numrin e subjekteve te performuara për një performace. Përfundimisht janë dhënë numrat e subjekteve te performuara brenda një viti kalendarik.</i>						